



AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCËS
AUTORITET KOSOVA ZA KONKURENCIJU
KOSOVO COMPETITION AUTHORITY

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Prishtinë, më 15.09.2022

Vendimi nr. 33/22

Duke u bazuar në nenet 11,13,15,16,17,18,26,27 dhe 55 të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, nenet 18 dhe 20 të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2012 Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve si dhe Udhëzimin Administrativ Nr.02/2018 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës, në mbledhjen e datës 15.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. LEJOHET Përqendrimi i ndërmarrjeve Preduzeče Za Proizvodnju i Promet Vode Vlasinka Doo Beograd, Zemun, Republika e Serbis (blerës) dhe Allied Beverages Adriatic d.o.o Beograd, Zemun, Republika e Serbis (shitës), për blerje të aksioneve të Homoljska Voda d.o.o Neresnica (targeti).

Preduzeče za Proizvodnju i Promet Vode Vlasinka doo Beograd, Zemun, Republika e Serbis është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me numër të regjistrimit të biznesit 17198114, NIT: 100000985 dhe adresë të regjistruar në 14-16 Batajnički drum, Zemun, Beograd, Republika e Serbi, tash e tutje referuar si "Vlasinka". Aktiviteti i regjistruar i biznesit të "Vlasinka" është prodhimi i pijeve joalkoolike dhe prodhimi i ujërave minerale dhe ujërave të tjera në shishe.

Allied Beverages Adriatic d.o.o (ABA) është shoqëri tregtare e regjistruar në përputhje me ligjet e Republikës së Serbisë në Beograd, me seli në Batajnički drum nr.18, me numër të regjistrimit 21357472. ABA nuk kryen aktivitete tjera biznesore, përveç atyre që janë të ndërlidhura me brendin dhe produktin e ujit në shishe Rosa. Aktiviteti i regjistruar i biznesit të ABA është prodhimi i pijeve freskuese, uji mineral dhe ujëra tjera në shishe.

Homoljska Voda d.o.o Neresnica është shoqëri me përgjegjësi të kufizuara me numër të regjistrimit të biznesit 17485962 dhe adresë të regjistruar në 2A Homoljska, Neresnica, Kučevë, Republika e Serbisë. Ndërmarrja e synuar është poseduese e lejes për shfrytëzimin e ujërave nëntokësore nga burimet që ndodhen në Neresnicë (Kučevë) dhe lejës përkatëse ujore (lejës për nxjerrjen e ujit), e cila shitjen e bën tek ABA, përkatësisht

ujin e pa ambalazhuar. Aktiviteti i regjistruar i biznesit të Ndërmarrjes së synuar, është prodhim i pijeve joalkoolike, ujërave minerale dhe ujërave të tjera, në shishe.

Ndërmarrja e synuar është nën kontrollin e ABA-s, e cila zotëron 100% të aksioneve të Homoljska Voda d.o.o Neresnica.

II. CCH Kosova është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me numër unik të identifikimit 810482216 dhe adresë të regjistruar në Laplje Selo, kilometri i pestë, Rr. Prishtinë-Shkup, Republika e Kosovës Aktiviteti primar i regjistruar i biznesit të CCH Kosova është prodhimi, shpërndarja e pijeve jo-alkoolike, ujërave minerale dhe ujërave të tjerë, në shishe. CCH Kosova është nën kontrollin dhe pronësinë e 100% të Coca-Cola HBC Holdings II B.V. dhe nën kontrollin e tërthortë të CCH.

III. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguaj taksë administrative prej 100.00 € (njëqind euro) dhe për Vendimin për lejimin e Përqendrimit në vlerë prej 3,000.00 € (tre mijë Euro).

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës më datë 05.08.2022, ka pranuar kërkesën me numër të protokollit 207/22-07/H, lidhur me njoftimin për Përqendrimin e ndërmarrjeve, përmes përfaqësueses me autorizim znj. Afrore Shapi, adresa rr. "Ali Pashë Tepelena", Ivy Residence nr.12, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, për ndërmarrjet Preduzeće Za Proizvodnju i Promet Vode Vlasinka Doo Beograd, Zemun (blerësi) do të blej nga Allied Beverages Adriatic d.o.o Beograd, Zemun (shitësi) 100% të aksioneve të kapitalit aksionare të Homoljska Voda d.o.o Neresnica.

Kërkesa për përqendrim në Republikën e Kosovës është bërë për arsye se brendet e The Coca-Cola Company dhe CCH produktet shpërndahen në tregun e Kosovës, përmes CCH Serbia dhe CCH Kosova. The Coca-Cola Company dhe CCH përmes kompanive bijë të tyre, përbëjnë sistemin e Coca-Cola i cili, vendos produktet në tregun e Republikës së Kosovës dhe disa tregje në shtetet dhe territoret fqinje, siç janë: pijet jo-alkoolike të gazuara, Coca-Cola, Fanta, Sprite, lëngje, pije të frutave ujë në shishe-Rosa, çaji, pije energjike, etj. Nga të dhënat e ofruara nga palët në përqendrim, vërejmë se Rosa Homolje, nuk është e disponoheshë në tregun e Kosovës.

Procedurat e ndjekura:

1. Vlerësimi i lëndës/dokumentacionit
2. Vërtetimi për kërkesën e dorëzuar me datë 17.08.2022.
3. Njoftimit për realizimin e përqendrimit në ueb faqen e AKK-së, më datë 15.08.2022

Kërkesa për Përqendrim është bazuar në marrëveshjen e paleve për shitblerjen e aksioneve, të datës 08.07.2022 me të cilin ndërmarrja Preduzeće Za Proizvodnju i Promet Vode Vlasinka Doo Beograd-Zemun, do të blej nga Allied Beverages Adriatic d.o.o

Beograd-Zemun, 100% të aksioneve të kapitalit aksionar të Homoljska Voda d.o.o Neresnica, Andaj, ne bazë të kërkeses Sekretariati i Autoritetit ka bere vleresimin e kerkeses per Perqendrim.

Baza Ligjore:

Sipas nenit 13, të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, nga dokumentacioni i prezantuar në dosjen e lëndës, palët përmbushin detyrimin për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

- a) Qarkullimi i kombinuar i palëve në tregun ndërkombëtarë e kalon shumën 20,000,000.00 Euro.
- b) Qarkullimi i një pale në Përqendrim e kalon shumën 1,000,000.00 Euro.
- c) Qarkullimi i palëve në tregun brendshëm e kalon shumën 3,000,000.00 Euro.
- d) “Vlasinka” do të blej nga ABA 100% të aksioneve në kapitalin aksionar për fitimin e kontrollit të drejtpërdrejt individual në kompani Homoljska Voda d.o.o Neresnica.
- e) Kontrata e Shitblerjes ndërmjet palëve e datës 08.07.2022

Vlerësimi i Konkurrencës

Tregu Relevant: Shpërndarjen e pijeve alkoolike dhe jo alkoolike. Transaksioni nuk do të ketë ndikim negativ në konkurrencën në tregun relevant dhe do të jetë neutral nga aspekti i konsumatorëve.

Tregu i Produktit: ofron prodhimin dhe shitjen më shumicë të ujit mineral të gazuar dhe ujëra tjera në shishe (uji natyral burimi Rosa) po ashtu bënë prodhimin e pijeve alkoolike dhe jo alkoolike dhe shpërndarjen e Coca-Cola, Fanta, Sprite, lëngje, pije të frutave ujë në shishe Rosa, çaji, pije energjike etj.

Tregu Gjeografik: vlerësimi i transaksionit, shoqëria e blerë është e pranishme në tregun Serbisë dhe nuk është në asnjë mënyrë aktiv dhe nuk ka veprimtari në tregun e Republikën së Kosovës, rrjedhimisht nuk ka mbivendosje të aktiviteteve të shoqërisë së blerë, në tregun e Kosovës, por blerësi gjeneron shitje përmes CCH Kosova dhe CCH Serbia, prandaj elementi gjeografik i tregut, mund të përcaktohet si kombëtar, d.m.th., si i gjithë territori i Republikës së Kosovës
Tregu gjeografik në transaksionin e propozuar, do të jetë tregu i Serbisë.

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar

Transaksioni i propozuar është transaksion, që do të realizohet në tregun gjeografik të Republikës së Serbisë, kërkesa për njoftim të përqendrimit është bërë për arsye se njëra nga palët ka prezencë përmes shitjeve të pijeve freskuese, ujë mineral dhe ujëra të tjera në shishe, përmes CCH Serbia dhe CCH Kosova në Republikën e Kosovës. Sipas vlerësimit të përqendrimit nga ky transaksion nuk do të ketë efekte negative për konkurrencën, rrjedhimisht për konsumatorët në Republikën e Kosovës. Nga të dhënat e ofruara vërejmë

se targeti nuk është prezent në tregun e Republikës së Kosovës, përmes personit juridik ose nëpërmjet shitjeve direkte dhe si i tillë, nuk ka mundësi të bëjë ndryshim në strukturën (horizontale apo vertikale) të tregut. Transaksioni si i tillë, nuk qon në kufizim, shtrembërim ose parandalim të konkurrencës në Republikën e Kosovës, rrjedhimisht në tregun përkatës dhe nuk do të këtë ndikim, qoftë në krijimin apo forcimin e pozitës dominuese.

Shënim:

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti konkurruese, do të jetë nën monitorimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

IV. Ky vendim, hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit, nga Komisioni.

Me këtë Vendim të njoftohen:

- Palët
- Arkiva

KOMISIONI

Kaltrina Sela
Zv. Kryetare



Nafije Osdautaj
Anëtare

